



Republika e Kosovës

757/20 Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br. _____
Date/Datum. 29.10.20
PRISHTINE - PRISHTINA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 757/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Agrounion” SH.P.K - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Agro Gresa” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me farë gruri”, me nr. të prokurimit: 651-20-4773-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan, më datë: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Agrounion” SH.P.K – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me farë gruri”, me nr. të prokurimit: 651-20-4773-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me farë gruri”, me nr. të prokurimit: 651-20-4773-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Agrounion” SH.P.K - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Agrounion” SH.P.K - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 05.10.2020 me nr. 757/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me farë gruri”, me nr. të prokurimit: 651-20-4773-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjilan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe
- Neni 40 dhe 41 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 14.10.2020, lidhur me pretendimin ankimorë të OE-ankues sqaron si në vijim:

OE ankues pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit sipas vendimit të AK-së. Komisioni profesional i vlerësimit të AK-së ka vizituar depon e aplikuesve dhe ka konstatuar se: Depo e “Agrounion” SH.P.K e kontraktuar nuk i plotëson kushtet për shkak të hapësirës së vogël ose më saktësisht kushtet e deponimit të farës. Gjithashtu lokacioni ku është depoja nuk disponon me hapësirën e parkingut për mjete transportueseve të rreth 1000 fermerëve të cilët furnizohen me farë Gruri. Komisioni gjithashtu merr në konsideratë edhe frekuencën e madhe të automjeteve ku është depoja (rruga Gjilan - Preshevë).

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate është: “Për kompanitë të cilat janë jashtë territorit të Komunës së Gjilanit duhet të kenë një punkt ose depo për shpërndarje të farës apo të ketë një para marrëveshje mbi marrjen e lokalit me qira në qytetin e Gjilanit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Për kompanitë të cilat janë jashtë territorit të Komunës së Gjilanit duhet të kenë një punkt ose depo për shpërndarje të farës apo të ketë një para marrëveshje mbi marrjen e lokalit me qira në qytetin e Gjilanit – Marrëveshja duhet të jetë origjinale e nënshkruar dhe e vulosur”.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se arsyeja e eliminimit

nga AK sa i përket hapësirës së vogël ose kushteve të deponimit të farës nuk qëndron sepse në nenin 9.1 & 9.2 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit nuk është kërkuar decidivisht se sa e madhe duhet të jetë depo, rrjedhimisht ky pretendim ankimorë në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e dytë që AK arsyeton vendimin se lokacioni ku është depoja nuk disponon me hapësirë parkingu për mjetet transportuesve të rreth 1000 fermerëve të cilët furnizohen me farë gruri, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka marrëveshje për qira për depon e cila është konform dosjes së tenderit dhe si dëshmi OE ka ofruar marrëveshje për qiranë andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Në nenin 41.11 të RROUP thuhet:

Andaj eksperti shqyrtues sqaron se arsyet e eliminimit të AK-së për OE nuk qëndrojnë për shkak se nuk kanë qenë të specifikuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 14.10.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se nuk qëndron arsyeja e eliminimit sipas vendimit të AK-së. Komisioni profesional i vlerësimit të AK-së ka vizituar depon e aplikuesve dhe ka konstatuar se: Depo e "Agrounion" SH.P.K e kontraktuar nuk i plotëson kushtet për shkak të hapësirës së vogël ose më saktësisht kushtet e deponimit të farës. Gjithashtu lokacioni ku është depoja nuk disponon me hapësirën e parkingut për mjete transportuese të rreth 1000 fermerëve të cilët furnizohen me farë Gruri. Komisioni gjithashtu merr në konsideratë edhe frekuencën e madhe të automjeteve ku është depoja (rruga Gjilan - Preshevë).

Paneli shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate është: "Për kompanitë të cilat janë jashtë territorit të Komunës së Gjilanit duhet të kenë një punkt ose depo për shpërndarje të farës apo të ketë një para marrëveshje mbi marrjen e lokalit me qira në qytetin e Gjilanit", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Për kompanitë të cilat janë jashtë territorit të Komunës së Gjilanit duhet të kenë një punkt ose depo për shpërndarje të farës apo të ketë një para marrëveshje mbi marrjen e lokalit me qira në qytetin e Gjilanit – Marrëveshja duhet të jetë origjinale e nënshkruar dhe e vulosur".

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se arsyeja e eliminimit nga AK sa i përket hapësirës së vogël ose kushteve të deponimit të farës nuk qëndron sepse në nenin 9.1 & 9.2 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit nuk është kërkuar decidivisht se sa e madhe duhet te jetë depo, rrjedhimisht ky pretendim ankimorë në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e dytë që AK arsyeton vendimin se lokacioni ku është depoja nuk disponon me hapësirë parkingu për mjetet transportuesve të rreth 1000 fermerëve të cilët furnizohen me farë gruri, Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues ka marrëveshje për qira për depon e cila është konform dosjes së tenderit dhe si dëshmi OE ka ofruar marrëveshje për qiranë andaj ky pretendim ankimor është i bazuar.

Në nenin 56.3 i LPP-se dhe neni 41.11 te RROUP specifikon se asnjë OE nuk mund te eliminohet per kërkesa qe nuk janë kërkesa te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Andaj arsyet e eliminimit të AK-së për OE nuk qëndrojnë për shkak se nuk kanë qenë të specifikuar në dosjen e tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 56.3 dhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna Gjilan
- 1x1 OE -"Agrounion" SH.P.K – Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.